

ZUSAMMENHALT
EMPATHIQUE



RESPEKTVOLL
COLLABORATION

Vendvarrim për myslimane dhe për myslimanë

Varrimi në varrezat e Madretsch-it

Vendvarrimi për myslimane dhe për myslimanë

Varrimi në varrezat e Madretsch-it

Vendvarrimi për myslimane dhe myslimanë në varrezat e Madretsch-it është një vendvarrim arkivolesh në kolona, i cili disponon me mbi 400 vende për varrim të drejtuara nga Meka. Në të nuk varrosen urna me hi. Varrezat do të ndahen sipas radhës së rasteve të lajmëruara të vdekjes dhe mund të pajisen me një përmendore (gur varri) ose të dekorohen me bimësi sipas dëshirës.

E drejta

Të drejtë për t'u varrosur në varrezat e Madretsch-it, në vendvarrimin për myslimane dhe myslimanë, kanë myslimanet dhe myslimanët që para vdekjes kanë qenë banues rezidentë në qarkun administrativ të Biel/Bienne. Gjithashtu, të drejtë për një varr kanë edhe fëmijët e familjeve myslimane nga Biel-i të lindur të vdekur, ashtu si dhe fëmijët me vdekje të hershme.

Regjistrimi

Pas rastit të vdekjes duhet informuar një ndërmarrje funerale. Kjo ia paraqet rastin e vdekjes administratës së varrezave. Me këtë rast sipërmarrësi ka nevojë për këto dokumente:

- Dëftesën mjekësore të vdekjes dhe/ose formularin – njoftimin për vdekjen
- Librezën familjare, pasaportën ose letërnjoftimin për të huaj të personit të vdekur
- Dokumentet e identifikimit të personave përgjegjës për njoftimin. Persona përgjegjës mund të jenë: bashkëshortja/bashkëshorti, fëmijët dhe bashkëshortët/-et e tyre, njeriu më i afërt i të vdekurit i pranishëm në vend, sponsor, kujdestari ose personat me autorizimin përkatës.

Administrata e varrezave në konsultim me të afërmit cakton datën e varrimit. Rregulloret në Zvicër nuk lejojnë që varrimin të bëhet brenda 24 orësh, siç parashikohet në Islam. Varrimi mund të bëhet jo më herët se 48 orë pas çastit të vdekjes. Administrata e varrezave përpiqet të kryejë varrimin sa më shpejt që të jetë e mundur. Deri në çastin e varrimit, sipas dëshirës, i vdekuri do të shtrohet ose do të vendoset në dhomën frigoriferike.

Larja

Në varrezat e Madretsch-it është në dispozicion një dhomë për larje rituale. Kufoma do të lahet prej familjarëve, anëtarë të bashkësisë myslimane. Qiraja për dhomën do të shënohet në faturë nga ana e administratës së varrezave. Dhoma për larje rituale mund të merret me qira edhe atëherë kur kufoma nuk do të varrosset në vendvarrimin për myslimane dhe për myslimanë.

Varrimi

- Varrimi mbahet rreth orës 10.00. I gjithë ceremoniali shoqërohet prej një imami. Deri tek varri arkivoli do të bartet nga familjarët/pjesëtarët e bashkësisë fetare myslimane.
- Arkivoli do të ulet në varr nga punonjësit e varrezave. Të gatshme për një mbulim simbolik të varrit nga ana e të afërmeve janë një tas me dhë dhe një lopatëz dore. Mbulimi faktik i varrit merret përsipër nga punonjësit e varrezës.
- I vdekuri/e vdekura do të varrosset në një arkivol të thjeshtë prej druri, ngase në Zvicër ekziston detyrimi për arkivol. Varrimi vetëm me çarçaf (qefin) është i ndaluar. Në vende publike kapaku i arkivolit mbahet i mbyllur. Meshkujt dhe femrat do të varrosen në të njëjtin vendvarrim, pa ndarje.

Varri

Mbi varr mund të vendoset një përmendore (gur varri), nëse trajta e saj (e tij) i përgjigjet udhëzimeve të qytetit të Bielit. Para fillimit të punimeve duhet dorëzuar një kërkesë në administratën e varrezave (origjinali bashkë me një kopje). Mirëmbajtja dhe përkujdesja për varrin është një çështje që u përket familjarëve. Sende të tilla, si guralecë, flamuj apo pajisje elektronike, janë të ndaluara dhe do të hiqen nga punonjësit e varrezës. Administrata e varrezave mund të marrë përsipër mbjelljen e bimëve dekorative dhe mirëmbajtjen e varrit kundrejt një tarife.

Heqja e varrit

Kohëzgjatja ligjore e kohës së prehjes për një varrim me arkivol në varrezat e Madretsch-it zgjat 25 vjet. Kjo do të thotë që një varr i caktuar, pas 25 vitesh të ndërtimit të tij, do të hiqet. Zgjatja e këtij afati nuk është e mundur. Përmendorja dhe dekorimet bimore do të hiqen, mirëpo mbetjet mortore do të mbeten nën dhë. Kësisoj, prehja për të vdekurin do të respektohet edhe pas heqjes së varrit.

Shpenzimet

Varrimi në vendvarrimin për myslimane dhe për myslimanë kushton 950 franga për të rritur, ndërsa për fëmijë deri në tetë vjet 700 franga. Këtyre mund t'u shtohen eventualisht edhe kostot për shfrytëzimin e lokaleve dhe shërbime të tjera. Nga ana e administratës së varrezave shpenzimet do t'u faturohen familjarëve. Të dhënat për shpenzimet nënkuptohen pa TVSH. www.biel-bienne.ch/cimetiere/couts Shpenzimet e varrmihësit do të faturohen veçmas nga sipërmarrja funerale.

Rregullorja dhe dispozita mbi sistemin e varrimit dhe të varrezave të qytetit të Biel-it vlen gjithashtu edhe për vendvarrimin për myslimane dhe myslimanë. Dokumentet janë në dispozicion nga administrata e varrezave.

Kontaktimi

Ville de Bienne, Cimetières et ensevelissements
Route de Brügg 121, 2503 Bienne
+41 32 326 26 61, cimetiere@biel-bienne.ch
www.biel-bienne.ch/cimetiere

Orari i hapjes

Varrezat Madretsch:	Akses të lirë në çdo kohë.
Salla e varrimit:	Hë-Di: 08.00–20.00
Administrata e varrezës:	Hë-En: 08.00–11.30, 13.30–16.30
	Pr: 08.00–11.30, 13.30–16.00